

## **R R E G U L L O R E**

**Nr 11 date 17.09.1988**

### **PER DHENIEN, HEQJEN E DESHMISE SE AFTESISE DHE SHQYRTIMIN E KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE NE HEKURUDHE**

Ne mbeshtetje dhe per zbatim te neneve 28, 43, dhe 44 te Kodit hekurudhor Republikes se Shqiperise, ministria e Transporteve nxjerr kete.

## **R R E G U L L O R E**

### **I. Dispozita te pergjitheshme**

1. Deshmia e aftesise eshte dokumenti qe verteton se mbajtesi i saj zoteron njohurite e nevojeshme profesionale dhe lejojet te ushtroje dertyren e caktuar ne deshmi. Deshmia e aftesise mbahet me vehte nga punojesit kur ata ndodhen ne kohen e sherbimit.

2. Paisen me deshmi aftesie, pasi tju jene nenshtruar provave, te gjithe punonjesit puna e te cileve ka lidhje me organizimin dhe sigurimin e levizjes se trenave si me poshte.

- a. Dispeceri i qarkullimit ne rajonet e stacionet hekurudhore
- b. Inspektori i sherbimit
- c. Kryetari trenit
- d. Manovruesi
- e. Nderruesi
- f. Frenuesi
- g. Roja i kaleses
- h. Shoqeruesi i vagonit
- i. Instruktori mashinist
- j. Mashinisti
- k. Ndhimes mashinisti

- l. Kryekontrollori i vagonave
- m. Kontrollori i vagonave
- n. Elektromekaniku i shenjezimit dhe i aparatures SCB-se
- o. Mekaniku i shenjezimit
- p. Tekniku i vijes hekurudhore
- q. Brigadier i mirmbajtjes se vijes hekurudhore
- r. Roja e binareve

3. Caktimin dhe pergatitjen e punonjesve qe do te pajisen me deshmi aftesie e bejene qendrat e punes se Drejtorise se Pergjitheshme te Hekurudhave, si dhe ndermarjet qe kane vija dhe mjete hekurudhore, te cilat i dergojne kerkesat, sipas profesioneve ne Inspektoriatin Hekurudhor.

4. Deshmia e aftesise leshohet vetem nga komisione te posacme te kualifikimit te ngritura nga Drejtori i Inspektoriatit Hekurudhor ne perberje te se ciles marin pjese dhe punonjes te Drejtorise se Pergjitheshme te Hekurudhave dhe qendrave te saj te punes Per profesionet: dispecer qarkullimi, inspektor mashinist, teknik vije, kryetar treni e shoqerues vagoni udhetaresh, kontrollor vagonash, inspektor sherbimi, brigadier i mirembajtjes se vijes hekurudhore, kryekontrollor vagonash, per kursantet e shkolles se komunikacionit dhe nxenesit e shkolles se mesme te Profilit Hekurudhor, deshmia e aftesise leshohet nga komisioni i posacem i kualifikimit i inspektoriatit hekurudhor.

Ndersa per profesionet: manovrues, nderrues, frenues, roje kalimi, roje binary, elektromekanik shenjezimit dhe i centralizim bllokimit, mekanik i shenjezimit e ndihmes mashinist, deshmia e aftesise leshohet nga komisionet e posacme te kualifikimit te qendrave te punes te Drejtorise se pergjitheshme te Hekurudhave.

5. Linja, forma dhe permbajtja e deshmise se aftesise eshte sipas modelit bashkelidhur.

6. Ndalohet te udhtroje profesionet e permendura ne piken 2 te ketij kreu te gjithe punonjesit qe nuk jane te paisr me deshmine e aftesise perkatese, ata qe e kane humbur ose e kane bere te paperdoreshme deshmine, si dhe u ka kaluar afati i rikontrollit te aftesise.

7. Ndalohet perdorimi i deshmise per qellime udhetimi ne tren.

8. Deshmia e aftesise leshohet me afat 2 vjecar

Riprovimet per mbrojtjen e deshmise zhvillohen ne muajin Shtator, ne komisionet e qendrave te puens te Drejtorise se Pergjitheshme te Hekurudhave dhe

ne muajin Tetor, ne komisionin e Inspektoriatit Hekurudhor, sipas ndarjes se bere ne piken 4 te ketij kreu.

Per punonjesit qe do te pajisen per here te pare me deshmi aftesie ten je shkalle me te larte, komisionet e posacem mblidhen cdo muaj.

9. Per cdo punonjes te paisur me deshmi aftesie ruhen dokumentat e nevojeshme.

Per punonjesit qe meren ne prova nga komisioni i kualifikimit Inspektoriatit Hekurudhor, dokumentat mbahen nga vete inspektoriatit, ndersa per punonjesit qe meren ne prova nga komisionet e qendrave te punes se Drejtorise se Pergjitheshme te Hekurudhave, ato ruhen nga zyrtar e kuadrit te ketyre qendrave.

10. Punonjesit e paisur me deshmi aftesie kane mundesi te punojne sipas nevojave te qendres se punes, ne detyren qe i percakton deshmia e aftesise ose nje detyre me te ulet kualifikimi, te cilat caktohen ne rradhen e meposhteme.

a. Dispecer qarkullimi, inspektor sherbimi, kryetar treni, manovrist, nderrues, frrenues, shoqerues vagoni, roje kalese.

b. Instruktor mashinist, mashinist, ndihmes mashinist.

c. Teknik vije, brigadier mirembajtjeje, roje binary.

d. Kryekontrollor vagoni, kontrollor vagoni.

## **II. Rregulla per pranimin ne provim dhe riprovim te punonjesve**

1. Te drejten per te hyre ne komisionin e kualifikimit e ka cdo punonjes qe ploteson keto kushte

a. Te kene mbushur moshen 18 vjec dhe te kete qendrim te mire moralo-shoqeror

b. Te mos kete te meta fizike, mendore dhe shendetesore, si demtime te rend ate organeve trupore ose mungesa ne gjymtyre, dobesi ne shikim dhe degjim, semundje te rend ate zemres, gjakut etj, te cilat pengojne ne kryerjen e sherbimit te levizjes trenave.

c. Te kete arsim perkates dhe stazhin e nevojeshem ne pune, sipas pasqyres ne kreun III te kesja rregullorje. Gjithashtu, ai duhet te ndjeke rregullisht kurset e kualifikimit qe zhvillon qendra e punes.

2. Punonjesit qe do te pajisen per here te pare me deshmi aftesie duhet te paraqesin keto dokumenta.

- Vertetim shkolle dhe kursit qe ka kryer si dhe te stazhit ne pune
  - Certifikaten e komisionit Mjekesor te leshuar jo me shume se nje muaj me pare
  - Dyfotografi dhe kuintancen e bankes me vleren perkatese te deshmise
3. Te gjithë punonjesit qe do te paraqiten ne komisionet e riprovimit jane te detyruar ti nenshtrohen kontrollit mjekesor periodik
- deri ne moshen 40 vjec..... cdo 5 vjet
  - deri ne moshen 50 vjec..... cdo 3 vjet
  - mbi moshen 50 vjec ..... cdo 2 vjet
4. Punonjesit qe dalin ne prova per te fituar deshmine e aftesise dhe ata qe mbajne ate duhet te kene dije te mjaftueshme per kodin dhe legjislacionin tjeter hekurudhor dhe te zoterojne njohurite e domosdoshme per detyren qe do te kryeje
5. Punonjesit kane te drejte te japin provimin ose riprovimin dy here rradhazi brenda 30 diteve. Ne rast se nuk i kane aftesite e duhura edhe ne radhen e dyte atehere e drejta per te fituar deshmine e aftesise i lind pas nje viti.
6. Kur nje punonjes i paisur me deshmi afesie, pavaresisht nga shkaku, nuk e ushtron profesionin per nje periudhe kohe mbi 6 muaj, ai nuk mund te punoje ne detyren qe cakton deshmi pa kaluar me pare ne provim.

**Kushtet e domosdoshme te arsimit dhe te vjetersise ne pune, per ngritjen profesionale nga nje shkalle me e ulet ne nje shkalle me te larte**

**III. Kushtet e domosdoshme te arsimit dhe te vjetersise ne pune per ngritjen profesionale nga nje shkalle me e ulet ne nje shkalle me te larte ( deshmi aftesie )**

1. Te gjithë punonjesit qe do te ngrihen ne nje kategori me te larte, pune para se te dalin ne prova, detyrimisht duhet te kene punuar nje muaj dublant ne detyren e re.
2. Ne rast te vecante, per nevoja te domosdoshme, me kerkese te qendres se punes dhe kur e cmon te arsyeshme Inspektoriati Hekurudhor, mund te dale ne prova per nje kategori me te larte ne pune ( deri ne detyren e mashinistit dhe inspektorit te

shebimit) cdo punonjes qe nuk e ka arsimin perkates, por me kusht qe te kete nje stazh pune te gjate ne detyren e kryer.

3. Drejtori i Inspektoriatit Hekurudhor, kur e kerkojne nevojat e punes, mund te autorizojte perkohesisht deri ne 3 muaj ushtrimin e nje detyre te nje shkalle me te larte kualifikimi, nje punonjes pa e paisur me deshmive e aftesise perkatese.

#### **IV. Shqyrtimi i shkeljes se dispozitave te Kodit Hekurudhor dhe i rregullave te tjera qe kane te bejne me sigurimin e levizjes se trenave dhe masat qe meren**

1. Shqyrtimi i shkeljes se dispozitave te Kodit Hekurudhor dhe i rregullave te tjera behet nga komisioni i Inspektoriatit Hekurudhor, nga komisionet e qendrave te punes, si dhe nga vete inspektoret e inspektoriatit hekurudhor. Perberja e komisioneve behet sipas percaktimit te pikes 4 te kreut te kesaj rregullorje.

2. Si rregull shkeljet shqyrtohen nga komisionet e qendrave te punes te Drejtorise se Pergjitheshme te Hekurudhave, ne territorin e te cilave kane ndodhur, pavaresisht se shkelesin nuk jane punonjes te asaj qendre pune. Per shkelje vecanerisht te renda dhe me pasoja te demshme shqyrtimi behet drejtperdrejt nga komisioni i Inspektoriatit Hekurudhor.

Ky komision gjithashtu shqyrton edhe shkeljet qe i paraqiten nga komisionet e qendrave te punes per competence. Analiza e shqyrtimit te shkeles, se bashku me propozimet perkatese i dergohen Inspektoriatit Hekurudhor brenda 5 diteve nga data e ndodhjes se tyre.

Inspektoret e Inspektoriatit Hekurudhor shqyrtojne kundravajtjet dhe vendosin per masen e denimit, sipas nenit 43 te kodit hekurudhor.

3. Denimet apo masat e marra nga komisionet e shqyrtimit te kundravajtjeve dhe nga inspektoret e vecante, jane te detyrueshme per zbatimin nga Drejtoriae Pergjitheshme e Hekurudhave dhe qendrat e saj te punes kundravajtje sipas rastit merren keto masa:

##### **A. Nga komisioni i Inspektoriatit Hekurudhor**

- a. Qortimi shoqeror
- b. Gjore deri ne 1.000 leke
- c. Heqje deshmive perkohesisht per kohen 3 muaj deri ne 1 vit.
- d. Zevendesoni i deshmive te aftesive te nje shkalle me te larte ne deshmi te nje shkalle me te ulet.

Koha e zevendesimit te deshmive nuk duhet te jete me e vogel se 3 muaj.

e. Heqje e deshmise se aftesise.

**B.Nga komisionet e qendrave te punes te Drejtorise se Pergjitheshme te Hekurudhave.**

- a. Qortimi shoqeror
- b. Gjobe deri ne 5.000 leke

Keto masa aplikohen vetem ndaj punonjesve, qe jane ne kompetencen e komisioneve te qendrave te punes te Drejtorise se Pergjitheshme te Hekurudhave per ti paisur me deshmi aftesie.

c. Zevendesim i deshmive te aftesise te nje shkalle me te larte ne deshmi te nje shkalle me te ulet per kohen 3 muaj.

d. Heqje deshmie perkohesisht per kohen 3 muaj deri ne 6 muaj.

5.Per masat e mara nga inspektorët e Inspektimit Hekurudhor njoftohet komisioni i posacem i Inspektoriatit Hekurudhor dhe kur ky i fundit shikon te arsyeshme, ka te drejte tia terheqe ceshtjen per shqyrtim vete, duke pezulluar njekohesisht masat e inspektorit.

6. pas plotesimit te afatit te denimit, punonjesi, me kerkesen e tij, me pelqimin e qendres se punes, mbron deshmive e aftesise, sipas rastit ne komisionin e Inspektoriatit hekurudhor ose ne komisionin e qendres se punes.

**Shenim:**\_Mbrojtja e deshmise do te behet ne ate komision qe ia ka hequr deshmive.

7.Vendimet e komisioneve te qendrave te punes te Drejtorise se Pergjitheshme te hekurudhave i kalojne menjehere zyres se kuandrit te ketyre qendrave te cilat, brenda dates 5 te cdo muaji informojne zyrtarisht Inspektoriatin Hekurudhor mbi ekzekutimin e vendimeve.

Per shkeljen e ketij afati ndaj shkaktareve merren masa disiplinore sipas Kodit te Punes.

8.Rregullorja Nr. 44 date 03.06.1987. “ Per dhenien dhe heqjen e deshmise se aftesise” dhe udhezimet e nxjerra ne zbatim te saj shfuqizohen.

9.Kjo rregullore hyn ne fuqi me 01.10.1988

MINISTRI  
Luan BABAMETO